

☆ Takim konsultativ i Kombeve të Bashkuara i Vendeve të Europës Lindore jo-anëtare të Bashkimit Europian për një Projekt Konventë Ndërkombëtare Integrale dhe Gjithpërfshirëse për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe dinjitetit të personave me aftësi të kufizuar

☆ Për një transport të përshtatur për personat me aftësi të kufizuar

Gjithpërfshirja e PAK në jetën shoqërore është një nga objektivat kryesorë të Strategjisë Kombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuar, në të cilën janë parashikuar objektiva dhe masa konkrete për realizimin, ndër të tjera, edhe të një transporti të përshtatur që mundëson lëvizjen e pavarur dhe është parakusht për integrimin e personave me aftësi të kufizuar në jetën shoqërore.

☆ Sot nis nje dite e re

Mendoka dikush dhe per ne romet me aftesi te kufizuara, pasi dhe ne jemi si gjithe te tjeret dhe kemi te drejte ta shijojme jeten” .

☆ Nje çift te verberish prej 10 – vitesh ne pritje te nje banese nga shteti

Në Shqipëri kemi prindërit tanë dhe gjithë të afërmit prandaj kërkojmë që të kemi një banesë tonën këtu ,pse jo pastaj të sjellim në jetë edhe një fëmijë për ti bërë kështu sfidë kësaj fatkeqësie.

## Personat me aftësi të kufizuara mendore dhe përgatitja e tyre për punë

(Dilema dhe zgjidhje)



Takim prezantues i draft konventes nderkombetare integrale qe promovon dhe mbron te drejtat e personave me aftesi te kufizuar

Personat me Aftesi te Kufizuara, perbejne 7- 10% te popullsisë, nderkohe qe ne Shqiperi burimet zyrtare te viteve te fundit shenojne nje shifer per rreth 80, 000 persona me aftesi te kufizuara.

# Në këtë numër

Deklarate e takimit konsultativ të Kombeve të Bashkuara të Vendeve të Europës Lindore Jo – Anetare të Bashkimit Europian për projekt –Konventën Nderkombetare, integrale për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar **Faqe 3**

Takim prezantues i Draft Konvents Nderkombetare Integrale që promovon dhe mbron të drejtat e personave me aftësi të kufizuar **Faqe 4**

Personat me aftësi të kufizuar mendore dhe përgatitja e tyre për punë ( dilema dhe zgjidhje) **Faqe 5**

Veç statuseve do të kete vetem nje ligj per aftesine e kufizuar **Faqe 9**

Zgjerimi i rrethit të perfituesve me ane te ligjit “ Per Sigurimet Shoqerore ne Republiken e Shqiperise” Nr. 7703, date 11.05.1993 ( i ndryshuar) **Faqe 11**

Nje çift te verberish prej 10 – vitesh ne pritje te nje banese nga shteti **Faqe 13**

Per nje transport te pershtatur **Faqe 15**

Sot nis nje dite e re **Faqe 16**

Tregim **Faqe 18**

Si te gatuajme receta te reja **Faqe 20**

**SHDPAK**  
FONDACIONI SHQIPTAR PER TE DREJTAT E PERSONAVE ME AFTESI TE KUFIZUARA  
www.adrf.org.al

## Sfida 21

REVISTË E PËRTREMUJSHME MAJ 2006

**Personat me aftësi të kufizuar mendore dhe përgatitja e tyre për punë (Dilema dhe zgjidhje)**



Takim prezantues i draft konventës ndërkombetare integrale që promovoi dhe mbron të drejtat e personave me aftësi të kufizuar



## Sfida 21

Revistë e përtremuajshme  
Financuar nga”  
Komiteti Suedez i Helsinkit për të  
Drejtat e Njeriut

**Swedish Helsinki Committee**  
**for Human Rights**

### Bashkëpunëtorë:

Bardhylka KOSPIRI  
Narbis BALLHYSA  
Virxhil NANO  
Entila ZYBA  
Brikena DEMIRAS  
Luiza PAPA  
Instituti i nxënësve që nuk  
shikojnë, Tiranë

Design and Layout  
Grafika ELZANA

Adresa:  
Rr.: “Mujo Ulqinaku”  
Nr. 26, Tiranë

Tel.Fax.: +355 4 266892

E-mail: adrf@icc.al.eu.org

www.adrf.org.al

www.adrf.org.al

# Takim konsultativ i Kombeve të Bashkuara i Vendeve të Europës Lindore jo-anëtare të Bashkimit European për një Projekt Konventë Ndërkombëtare Integrale dhe Gjithëpërfshirëse për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe dinjitetit të personave me aftësi të kufizuar

Në përputhje me frymën e partneritetit ndërmjet shoqërisë civile, qeverisë dhe Kombeve të Bashkuara, pjesëmarrësit përfaqësues të strukturave qeveritare dhe jo-qeveritare në Takimin Konsultativ të Kombeve të Bashkuara të Vendeve të Europës Lindore Jo-Anëtare të Bashkimit European për një projekt konventë ndërkombëtare integrale dhe gjithëpërfshirëse për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe dinjitetit të personave me aftësi të kufizuar miratuan me 23 Mars 2006 deklaratën e mëposhtme:

1. Është i nevojshëm edukimi në vijimësi lidhur me projekt konventën si për personelin e strukturave qeveritare dhe organizatat jo/qeveritare. Organizatat ndër-qeveritare dhe qeveria duhet të luajnë rol në këtë drejtim, në bashkëpunim me grupet e shoqërisë civile në nivel kombëtar. Edukimi duhet të drejtohet veçanërisht tek grupet e interesit përfshirë Ministrinë e Punëve të Jashtme, Ministrinë e të Drejtave të Njeriut, Këshillat Kombëtarë mbi Aftësinë e Kufizuar, anëtarët e parlamentit,

institucionet kombëtare për të drejtat e njeriut, personat me aftësi të kufizuar, organizatat që punojnë me personat me aftësi të kufizuar dhe grupe të tjera të shoqërisë civile.

2. Qeveritë, organizatat ndër-qeveritare dhe organizatat e shoqërisë civile duhet të përmirësojnë përcjelljen e informacionit lidhur me projekt konventën. Ky informacion duhet të përfshijë informacion lidhur me procesin e projektimit të konventës, përmbajtjen e saj si dhe ndjekjen e konventës pasi ajo të jetë miratuar – për shembull, lidhur me implementimin dhe monitorimin.

3. Pjesëmarrësit në këtë takim bëjnë thirrje për ngritjen e një organizmi koordinues që të përfshijë ekspertizë në nivel rajonal për të asistuar në veprim, koordinim dhe ndarjen e përvojës lidhur me konventën në nivel rajonal dhe ndërmjet organizatave të ndryshme lokale. Ky organizëm koordinues duhet të punojë për të promovuar dhe lehtësuar ratifikimin, implementimin dhe monitorimin.

4. Qeveritë dhe bashkëpunimi ndërkombëtar kanë rol në sigurimin e burimeve njerëzore, institucionale dhe financiare të nevojshme për të promovuar ratifikimin dhe monitorimin e konventës pasi ajo të miratohet. Burimet financiare nevojiten për të promovuar si për shembull krijimin e kuadreve ligjore bazuar në konventë, trainime, lobim, dhe ndërgjegjësim, si dhe shkëmbim të përvojës së praktikës së mirë.

5. Organizatat ndër-qeveritare në bashkëpunim me organizatat që punojnë me personat me aftësi të kufizuar dhe grupe përkatëse të interesit inkurajohen të krijojnë dhe të sigurojnë udhëzime dhe informacion tjetër në forma lehtësisht të aksesueshme në gjuhën lokale lidhur me projekt-konventën dhe implikimeve të saj për nivelin kombëtar. Është gjithashtu e nevojshme që të ketë udhëzime të qarta lidhur me monitorimin e projekt konventës kështu që grupet e shoqërisë civile të mund të pregatiten të monitorojnë konventën që nga fillimi.

# TAKIM PREZANTUES I DRAFT KONVENTES NDERKOMBETARE INTEGRALE QE PROMOVON DHE MBRON TE DREJTAT E PERSONAVE ME AFTESI TE KUFIZUAR

Një konventë ndërkombëtare gjithëpërfshirëse dhe integrale për të promovuar dhe mbrojtur të drejtat dhe dinjitetin e personave me aftësi të kufizuar do të japë një kontribut domethënës për të balancuar disavantazhin e thellë shoqëror të personave me aftësi të kufizuar dhe për të balancuar pjesëmarrjen në sferat shoqërore, politike, ekonomike dhe kulturore me mundësi të barabarta, si në vendet e zhvilluara dhe ato në zhvillim.



Personat me Aftësi të Kufizuara, perbejne 7- 10% te popullsisë, ndërkohe qe ne Shqiperi burimet zyrtare te viteve te fundit shenojne nje shifer per rreth 80, 000 persona me aftësi të kufizuara.

Në Organizatën e Kombeve të Bashkuara në New York është

të duke u diskutuar hartimi i një Konvente specifike për Personat me Aftësi të Kufizuar, e cila do të jetë dokumenti i parë dhe më i rëndësishëm që do të afirmojë dhe mbrojtë të drejtat e kësaj kategorie.

Kombet e Bashkuara, në Deklaratën Universale të të

Drejtave të Njeriut dhe në Paktet Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut, kanë shpallur dhe kanë pranuar që çdo njeri gëzon të gjitha të drejtat dhe liritë të parashtruara në to, pa asnjë dallim të çfarëdo lloji.

Pavarësisht nga të gjithë këto instrumente dhe ndërmarrje, personat me aftësi të





kufizuar vazhdojnë të ndeshen me barriera në pjesëmarrjen e tyre si anëtarë të barabartë të shoqërisë dhe mosrespektim të drejtave të tyre njerëzore në të gjitha anët e botës.

Një konventë ndërkombëtare gjithëpërfshirëse dhe integrale për të promovuar dhe mbrojtur të drejtat dhe dinjitetin e personave me aftësi të kufizuara do të japë një kontribut domethënës për të balancuar disavantazhin e thellë shoqëror të personave me aftësi të kufizuara dhe për të balancuar pjesëmarrjen në sferat shoqërore, politike, ekonomike dhe kulturore me mundësi të barabarta, si në vendet e zhvilluara dhe ato në zhvillim.

Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (FSHDPK), përmes një procesi të vazhdueshëm avokatie me Ministrinë e Punëve të Jashtme, që në vitin 2004 arriti të sigurojë angazhimin e


Qeverisë Shqiptare për përfshirjen e shtetit shqiptar në hartimin e kësaj draft konvente.

Shtetet pjesëmarrëse në hartimin e Draft Konventes kanë parashikuar miratimin e saj në sesionin e ardhshëm, që do të mbahet në New York, në Gusht 2006.

Për të bërë të njohur angazhimin e deritanishëm në këtë proces të shtetit shqiptar dhe shoqërisë civile, Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, me mbështetjen e Fondit Vullnetar të OKB-së për aftësi të kufizuara (UN Voluntary Fund on Disability) organizoi më 17 Mars 2006 në ambientet e Hotel Rogner- Europa Park, një takim prezantues të Draft Konventes Nderkombëtare Integrale që promovon dhe mbron të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, duke synuar të nxisë pjesëmarrje dhe kontribut aktiv të të gjithë ak-

toreve shqiptare në finalizimin e këtij dokumenti.

Prezenca dhe prononcimi në këtë takim i Ministrisë të Jashtme, Z. Besnik Mustafaj dhe i përfaqësuesve të tjerë të lartë të strukturave përgjegjëse, deshmoi vlerësimin dhe vëmendjen që Qeveria Shqiptare është duke i dhënë finalizimit të këtij procesi. Prezenca në këtë takim e organizatave të njerezve me aftësi të kufizuara, organizatave të tjera të fokusuara në fushën e të drejtave të njeriut si dhe partnereve të tjerë kombëtare dhe nderkombëtare, deshmoi interesin e gjithë komuni-



tetit në mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të gjithë personave me aftësi të kufizuara.

Aprovimi i Konventes, firmosja dhe ratifikimi i saj nga shteti shqiptar, do t'i kontribuojë përafërit të politikave të shtetit shqiptar në fushën e aftësisë së kufizuar me standartet ndërkombëtare. ■

# Personat me aftësi të kufizuara mendore dhe përgatitja e tyre për punë (dilema dhe zgjidhje)

Përgatitja për punë e personave me prapambetje mendore është e vlefshme jo thjesht vetëm për ekzistencën, por ndikon shumë në zhvillimin e tyre psikik: u rrit besimin në vetvete, ata bëhen më të përqëndruar, mësojnë të jetojnë në grup, afrohen me jetën normale.



Nuk është aspekt i ri fakti që personat me aftësi të kufizuara krahas arsimit bazë që marrin në shkolla speciale, apo të integruar në shkollat e zakonshme, kanë arritur edhe të përgatiten dhe përfshihen suksesshëm në tregun e punës. Përvoja ka treguar se, si përgatitja ashtu edhe gjetja dhe ruajtja e vendit të punës nuk është e lehtë. Do të parashtrijmë në këtë shkrim disa mendime nga përvoja jonë disa vjecare në përpjekje për aftësimin dhe punësimin e të rinjve me prapambetje mendore.

Përvoja e grumbulluar në vite pranë shkollës speciale “Luigi Gurakuqi” Tiranë ka treguar se mundësitë e personave me prapambetje mendore të shkallës së lehtë, pa përjashtuar edhe ata të shkallës së mesme, nuk duhen nënlehtësuar.

Sot, gjithnjë e më të paktë janë ata që mbrojnë idenë se personat që paraqesin prapambetje mendore të lehtë (koeficient intelektual 70-50) duhet të grupohen më vete; ata mund të përgatiten për punë në kushte normale për tu përfshirë në shoqëri. Për ata që paraqesin një prapambetje më të rënduar (koeficient intelektual 50-20) lind nevoja për krijimin e punishteve të përshtatura sipas

mundësive intelektuale dhe fizike. Në mjaft raste, biles dhe ata mund të punojnë jashtë këtyre atelieve që gëzojnë një përkujdesje të vecantë. Ka mjaft studime që flasin për format e përfshirjes së tyre në punë:

a) sa prej tyre arrijnë të sigurojnë ekzistencën (të marrin pagën e duhur)?

b) sa stabilitet kanë ata në punën që përfshihen etj.

Në një nga këto studime rezultoi se 70%-80% e personave që paraqesin prapambetje mendore të lehtë arrijnë të sigurojnë një ekzistencë minimale. Biles rezultoi se rendimenti që ata kanë në punë është më i lartë nga ai që kanë arritur dikur në shkollë. Kjo shpjegohet me faktin se në punë këta të rinj ndjehen më të motivuar, puna nuk kërkon po ato aftësi si shkolla, ka shumë lloje punësh që nuk kërkojnë të menduarit abstrakt apo atë induktiv-deduktiv. Nga ana tjetër, vet suksesi që arrijnë në punë nxit zhvillimin psikik, përmirëson zhvillimin e tyre intelektual.

Përfshirja në punë në një kolektiv varet jo vetëm nga vecoritë psikike të individit, por edhe nga natyra e kolektivit apo grupit ku përfshihesh. Mirëkuptimi, bashkëpunimi që ofrohet nga të tjerët përbëjnë katalizatorë mjaft pozitivë

për personat me aftësi të kufizuara mendore.

Mbështetur në vëzhgime dhe studime të bëra në vite të ndryshme rezultoi se:

- integrimi i tyre në ndërmarrje me pak punonjës është më i vështirë;
- në ndërmarrje ku ka më shumë se 50 punonjës ata integrohen më lehtë;
- kur shefi është pozitiv, tolerant dhe dashamirës, problemet janë më të pakta;

Përvoja tregon se kujdes i vecantë duhet bërë sidomos në fazën e parë të futjes së këtyre personave në punë. Edhe pse në shkollë mund të kenë formuar shprehje të mira, praktike në dhomat e punës, përfshirja në kolektivin e ndërmarrjes kërkon: tjetër ritëm, përshtatje, ke të bësh me një numër më të madh punëtorësh, vet ndryshimi i ambjentit ndikon. Të gjitha këto bëjnë që shumë të rinj me prapambetje mendore të c'orientohen, të mos ndjekin ritmin e duhur, vonohen në punë, nuk janë mësuar me sforcë, mungojnë, derisa edhe e lënë punën. Largimet më të shumta ndodhin kryesisht vitin e parë.

Të dhënat flasin se stabilitet më të madh kanë patur personat që janë angazhuar si bojaxhinj dhe më pak kopshtarët. Shumë kanë preferuar vende ku ka mundësi të lëvizin: postierë, roje, ndihmës kuzhinjer (sidomos vajza) dhe në ndërtim.

Përvoja tregon se vështirësitë e punësimit nuk lidhen edhe aq me nivelin intelektual të të rinjve, sesa me:

- vecoritë e karakterit
- qëndrueshmërinë apo paqëndrueshmërinë emocionale të individit
- aftësia e pakët për sforcë të qëndrueshme
- mos respektimi i rregullave dhe i ritmit të punës

Përfshirja e suksesshme ndodh më lehtë kur:

- personave u ofrohet mbështetje morale
- kur ata ndihmohen nga familjarët
- kur këshillohen dhe ka interesim për ta

Kur familja nuk ka mundësi ti ndihmojë, vet shkolla mund ta luaj një rol të tillë. Në këtë kuadër me vlerë janë edhe takimet për shkëmbim përvoja midis nxënësve të shkollës speciale dhe të rinjve me prapambjetje mendore që kanë qenë të suksesshëm në punë. Nga sa më sipër rezulton që shkolla duhet të vazhdojë ti ndjekë dhe ti mbështesë këta të rinj në procesin e punës si moralisht ashtu edhe nga pikëpamja profesionale. Për të lehtësuar përshtatjen e tyre duhet të planifikohet: një periudhë tranzicioni në punë, gjatë së cilës këta të rinj të njihen gradualisht me detyrat, punonjësit dhe proceset e punës; krahas kësaj, nëse mbelemi vetëm thjesht në vizita në ndërmarrje duhet që të shkohet më tej me praktike më kompakte si kohë dhe si formë të ushtruar.

Vite me parë shkolla speciale, Luigj Gurakuqi, mbasi bënte një eksplorim të ndërmarrjeve se ku mund të integroheshin këta të rinj, realizonte praktika në këto ndërmarrje duke rritur gjithnjë e më shumë kohën e punës. Këto vizita pune ishin mjaft të vlefshme për përshtatjen e të rinjve, njihjen e proceseve dhe krijimin e lidhjeve me punonjësit e tjerë të ndërmarrjes. Gjatë kësaj periudhe ndodhte

se dhe ata mund të jenë të vlefshëm. Në këtë këndvështrim, është e nevojshme që edhe kur janë në bankat e shkollës ata të angazhohen në "mini projekte pune", të punojnë më kontrata shkollë-ndërmarrje për prodhime të ndryshme si: lodra për kopshte, mjete didaktike (bërje figurash gjeometrike për shkollat normale duke përdorur mjete rrethore: copa druri, kartona, kanoce etj.).



një njohje e dy anëshme e palëve dhe ndërmarrjet pranonin më lehtë kontigjente të rinjsh që paraqesnin prapambjetje mendore. Gjatë këtij procesi këta të rinj mbështeteshin gjithashtu edhe nga mësues të punës nga shkolla speciale. Rëndësi në këtë fazë i kushtojmë edhe faktit që edhe prindërit apo vëllezërit e tyre më të mëdhenj të ndihmonin në këtë proces.

Në këtë situatë përfitimi ishte i dy anëshëm: të rinjtë ndjeheshin më mirë, punëtorët mësoheshin me ta dhe çdo vit pranonin në gjirin e tyre dy, tre nga këta nxënës.

Përgatitja më e mirë praktike e personave me aftësi të kufizuara ka të bëjë jo thjesht me fitimin e disa shprehive praktike, por sidomos me formimin e një qëndrimi të drejtë ndaj punës. Është e nevojshme që këta nxënës të ushtrohen që në klasa të ulëta të realizojnë objekte konkrete për të parë

Në këtë sens, kur në klasën e VII të shkollës speciale iu tha nxënësve të bëjnë X objekt që do të duhej në një kopësht, u vu re që të gjithë u angazhuan dhe ishin shumë rezultativ. Kur e njëjta gjë u bë me nxënës të klasës së VIII, për të bërë një send (karrige lodër) pa iu thënë përse duhej, u pa se asnjë nga nxënësit nuk u angazhua seriozisht.

Në procesin e përgatitjes së personave me aftësi të kufizuara për punë, një rëndësi e vecantë i duhet kushtuar formimit të shprehive të përgjithshme bazë për punë si:

- përgatitja e vendit të punës, veglave dhe materialeve që nevojiten
- analiza e kujdesshme e modelit
- organizimi i punës sipas etapave
- analiza e produktit të realizuar
- pastrimi i ambientit dhe lënia pastër e vendit të punës

Në një studim krahasues midis personave normalë dhe personave me prapambetje mendore, ju kërkua të dy palëve të shprehen se cilat elemente apo cilësi të punës preferonin duke i lexuar një listë me këto elemente:

- preferon punë që të pëlqen; që ke të bësh me njerëz të mirë; që do paguhesh më shumë; të jetë puna interesante, etj.



Në përfundim të punës rezultoi se preferencat e vajzave me prapambetje mendore ndryshonin me ato të vajzave normale në klasën e VIII. Vajzat që paraqesnin prapambetje mendore, si dhe vajzat e shkollës së zakonshme preferuan të punojnë me njerëz të mirë dhe në vende ku janë të sigurta. Në ndryshim me to djemtë me prapambetje mendore preferuan punët ku paguhen mirë. Kur u pyetën mbas shkolle se ku donin të shkonin për të punuar, djemtë përzgjedhën nga një listë punë të lehta ose punë që kishin të bënin me lëvizje të shumta.

Pavarësisht nga dëshirat e të rinjve është e nevojshme që përgatitja profesionale e tyre që në bankat e shkollës të lidhet më mirë me nevojat e tregut të punës. Një projekt i tillë u realizuar për dy vjet në shkollën speciale për fëmijë me prapambetje mendore të lehtë në Tiranë duke prodhuar qirinjtë të ngjyrave të ndryshme dhe duke i shitur ato. Kur të rinjtë me fitimin plus që nxorrën nga kjo veprimtari organizuan një ekskursion jashtë Tiranë, gjatë diskutimeve të lira me ta, nxënësit shprehën vec kënaqësisë dhe një kuptim më të mirë për punën. Të gjithë filluan të pyesnin prindërit e tyre dhe erdhën me ide të reja se çfarë duhet të prodhojnë dhomat e punës që të mund ti shesin më lehtë.

Nga studimet e bëra lidhur me mundësitë dhe punësimin e personave me prapambetje mendore, re-

zultun se niveli minimal mendor për të bërë një punë është 3-vjec, sigurisht në një moshë më të madhe dhe fizikisht më të fortë. Për nga vështirësia ky nivel pune thuhet është i ngjashëm me procese pune që kryhen në bujqësi. Në rastet kur personat me prapambetje mendore paraqesin edhe crregullime të tjera, si p.sh. hiperaktivitet, është e këshillueshme që të angazhohen në punë që përmbajnë lëvizje: të cojnë materiale nga një vend në tjetrin, të ndihmojnë në punë të ndryshme, të operojnë me vegla, të bëjnë kuti që përmbajnë procese prerje, palosje etj. dhe njëkohësisht të vlerësohen më shpesh duke i nxitur për punën që kanë bërë deri sa të stabilizohen.

Në përfundim, theksojmë se përgatitja për punë e personave me prapambetje mendore është e vlefshme jo thjesht vetëm për ekzistencën, por ndikon shumë në zhvillimin e tyre psikik: rrisin besimin në vetvete, bëhen më të përqëndruar, mësojnë të jetojnë në grup, afrohen me jetën normale.

Sic thamë edhe më sipër të mësuarit në vendin e punës ndikon në zhvillimin e vullnetit, disiplinës, modestisë dhe ndihmën reciproke.

- Krahas të tjerave duhet të marrim parasysh edhe kontra-indikacionet lëvizore, shëndetësore që mund të kenë këta fëmijë.
- Përgatitja për punë duhet të ketë karakter të individualizuar.

- Së fundi, puna e tyre duhet të ketë edhe vlerë edukative.

Ligji i ri "Për nxitjen e punësimit" nr.8862, datë 7.03.2002 (Paketa Ligjore mbi Aftësinë e Kufizuar) hap horizonte të reja në aspektin e punësimit për personat që paraqesin aftësi të kufizuara. Shteti i kushton rëndësi në mënyrë të vecantë formave të aftësimin, këshillimit dhe riaftësimin për punë të personave me aftësi të kufizuara. Në kreun IV "Punësimi i personave me aftësi të kufizuara", neni 15 theksohet:

1. Cdo punëdhënës që punëson më tepër se 24 punonjës, është i detyruar të punësojë një person me aftësi të kufizuar për cdo 25 punonjës të personelit të tij.

2. Një punëdhënës mund të punësojë një person me handicap të rëndë në vend të 5 personave me handicap të lehtë.

3. Inspektoristi Shtetëror i Punës kontrollon zbatimin e këtij neni.

Për sa më sipër, është e nevojshme që të gjitha organizatat qofshin këto qeveritare apo jo qeveritare duhet të angazhohen seriozisht për aplikimin konkret të këtij ligji i cili kursesi nuk gjen zbatim automatikisht. Ky ligj hap horizonte të reja që duhen shfrytëzuar e cuar më tej. Përvojat e mëparshme përbëjnë garanci për aplikimin konkret të tij.

Prof. Asoc. Dr. Virxhil Nano

**Marjeta Zaçe:**

# *Gati Sekretariati për Shanset e Barabarta*

Tani që detyra e ka lidhur me njerëzit me aftësi të kufizuara, zv.ministrja e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Marjeta Zaçe, ka takuar persona të shqetësuar nga probleme të pazgjidhura. “Kanë qenë shumë prekëse. Ajo admiron forcën dhe vullnetin që një pjesë e tyre kanë për të punuar dhe për të mposhtur fatkeqësinë natyrore. Zv.ministrja është në krye të grupit që po merret me studimin për ndryshimin e legjislacionit, që përfshin këtë kategori për të cilat ajo flet me detaje në një intervistë për gazetën “Panorama”.

**Për çfarë qëllimi është ngritur grupi i studimit të legjislacionit të aftësisë së kufizuara?**

Tani jemi në fazën e parë të punës. Kemi mbledhur të gjithë legjislacionin që ekziston aktualisht. Disa grupe kanë përgatitur drafte dhe ne do t'i marrin në konsideratë, ndaj synojmë që t'i paraqesim në Parlament më vonë. Ky rishikim bëhet jo thjesht sepse është ndërë si një domosdoshmëri për të pasur një bazë ligjore për të përfshirë të gjitha specifikat dhe veçoritë e këtyre grupeve. Edhe organizmat ndërkombëtarë që mbulojnë problemet e personave me aftësi të kufizuara, janë duke parë dhe po hartojnë konventën. Në të gjitha vendet e Evropës Juglin-

**“Veç stutuseve do të ketë vetëm një ligj për aftësinë e kufizuara”**

përfshihen në një ligj. Kuptohet kërkon një afat kohor, jo vetëm për të bërë një punë shumë të mirë, sepse studimi është duke vazhduar, por edhe për të krijuar bindjen e plotë që këto shtresa duhet të kenë atë trajtim që duhet nga një shtet social, ato do të mbështeten edhe nga ana ekonomike, apo edhe nga kushtet e tjera që duhet t'u përshtaten aftësive të tyre të kufizuara, në raport edhe me zhvillimin ekonomik të vendit dhe zhvillimin shoqëror.

dore do të jetë një legjislacion, që të mbulojë të gjithë problemet e këtyre shtresave. Parimet bazë janë të njëjta. Përderisa disa nga këto grupe, si të verbrit, invalidët e punës kanë statuset e tyre deri tani, insistojmë që të ruhen ato të drejta që ata i kanë fituar deri tani.

**A është ky ndryshim legjislacioni një kusht për anëtarësimin e vendit në Bashkimin Evropian?**

Patjetër si gjithë kushtet e tjera, edhe për barazinë gjinore, edhe kjo është arsyeja që kontaktet janë të përbashkëta. Jo vetëm që ky ligj nuk është për t'u hequr ato të drejta që kanë deri tani, por qëllimi është që të

**Me aq sa jeni informuar, si do ta gjykonit legjislacionin aktual? Ju duket se respektohen të drejtat e personave me aftësi të kufizuara? Nëse jo, si duhet të ndryshojnë gjërat në këtë drejtim?**

Zbatimi i ligjshmërisë së këtyre shtresave nuk është bërë në përmasat e duhura. Ka vende ku ligji nuk është zbatuar, jo vetëm për arsye të krijimit të aftësive, por edhe për moszbatim të ligjit nga persona që nuk kanë qenë të përgjegjshëm për t'i shërbyer kësaj shtrese. Megjithatë them se me fillimin e punës së qeverisë së re do ndryshojnë gjërat, me daljen e programit social.

Treguesit e zhvillimit ekonomik social të vendit kanë qenë shumë të ulët dhe për këtë arsye një pjesë e mirë e njerëzve jetojnë nën minimumin jetik. Këtu pa dyshim përfshihen të gjithë këto shtresa, sepse edhe paga që ata marrin është e një niveli të ulët, në krahasim me kërkesat e tyre, qofshin edhe ato shëndetësore që janë shumë herë më të mëdha për sa shteti u siguron. Mendoj se qeveria demokratike ka treguar një kujdes të veçantë, vazhdon të tregojë, dhe mbi të gjitha do të insistojë për shtetin ligjor. Nuk po themi që këto shtresa do të sigurojnë të gjitha të mirat, kuptohet që kjo vështirësi është për një pjesë të madhe të shqiptarëve, por e rëndësishme është që jeta e tyre të përmirësohet dhe ata të ndjehen të mbështetur sa nga shteti po aq edhe nga shoqëria. Janë edhe përpjekjet e tyre që nuk duhen mohuar, por një rezervë të madhe e shoh edhe te menaxhimi i projekteve që fitojnë ato. Duhet të jetë sa më i mirë menaxhimi, sepse ato përmirësojnë në mënyrë të ndjeshme jetën e këtyre personave. Për t'i bërë sa më aktivë është e vendosur në ligj që në çdo 25 persona, një duhet të jetë me aftësi të kufizuara dhe unë mendoj që edhe kjo nuk ka gjetur zbatim.

### Po si mund të rregullohet ky handicap?

Ka rreth dy javë që është miratuar nga qeveria ngritja e Sekretariatit për Personat me aftësi të Kufizuara pranë Drejtorisë së Shanseve të Barabarta. Ai do të ketë detyrë të monitorojë në vazhdimësi, veç politikave që do t'i bëjë Këshilli Ndërmnishtor, ai do të përgatisë gjithçka që ka të bëjë me politikën për përmirësimin e jetës së kësaj sh-

trere. Në përbërje të këtij sekretariati të ketë një person me aftësi të kufizuara. Ky do të jetë një shembull, që nga vetë struktura, e cila do të mbulojë këtë pjesë.

### Çfarë modeli do të merret për të realizuar këtë ligj?

Jemi në fazën e parë dhe nuk e kemi përcaktuar. Me aq sa jam informuar, ajo shtresë që është me afër këtyre njerëzve, siç janë të afërme, ato bëhen shumë herë më aktivë për t'u shërbyer këtyre shtresave. Pikërisht me këto kategori kemi bashkëpunuar dhe ata janë të aftë të sjellin çka ofron legjislacioni më i mirë bashkëkohor, për ta bërë ne pjesë të studimit dhe për të qenë nesër më të sigurt. Ka pjesë shumë të mira edhe në legjislacionin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, por që ndonjëherë nuk mund të realizohen këtu.

### Ju vetë keni takuar ndonjëherë një person me aftësi të kufizuara dhe si jeni gjendur?

Unë kam pasur shumë kontakte me persona me aftësi të kufizuara, që nga fillimi i kësaj detyre, mbase edhe për shkak të të qenit grua tregon në një farë mase më shumë dhembshuri. Ata herë të shqetësuar nga probleme të pazgjidhura, por herëherë edhe me dëshirën e mirë për të pasur një kontakt. Kanë qenë shumë emocionuese, prekëse. Ajo që unë admiroj është forca dhe vullneti që një pjesë prej tyre kanë për të punuar, dhe për të mposhtur fatkeqësinë natyrore dhe dëshirën që ata kërkojnë të kenë vlerësimin e tyre në shoqëri.

*Brikena Demiras  
Gazetare,  
Gazeta "Panorama"*

**K**ushtetuta e Republikës të Shqipërisë ka sanksionuar në nenin 52/1 "Kushdo ka të drejtën e sigurimeve shoqërore në pleqëri ose kur është i paaftë për punë, sipas një sistemi të caktuar me ligj".

Në këtë mënyrë, Kushtetuta e RSH i njeh të drejtën çdo individi, i cili ka derdhur kontribute në skemën e sigurimeve shoqërore, për të përfutur pensionin e pleqërisë (për të moshuarit) dhe pensionin e invaliditetit për personat të cilët deklarohen të paaftë për të punuar, me vendim të Komisionit të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAPI).

Në mënyrë specifike neni 52/1 i Kushtetutës, ka gjetur shprehje në Ligjin Nr.7703, date 11.05.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar), ku sipas këtij ligji, sistemi i sigurimeve shoqërore, parashikon mbrojtje të detyrueshme për të gjithë;

➤ personat e punësuar, *punëmar-rësit*, në rastin e pakesimit të të ardhurave si *pasoje e paaftësisë së perkohshme të shkaktuar nga semundja, barrëlindja, aksidenti në punë, semundja profesionale, .... etj....*

➤ personat e tjerë ekonomikisht aktivë (punëdhënësit dhe të vetpunësuarit), që ushtrojnë veprimtari ekonomike pavarësisht nga kohëzgjatja e saj, për përfitimin e pensionit të pleqërisë. *invaliditeti .... etj....*

Ligji "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë" me ndryshimet që pësoi me Ligjin nr. 9377 datë 21.04.2005, duhet të theksojmë se ndër të tjera solli zgjerim të rrethit të përfituesve të cilat kryesisht i vijnë në ndihmë kategorisë së parë të invaliditetit por ende lënë të pa mbuluar kategoritë e tjera.

# Zgjerimi i rrethit të përfituesve me anë të Ligjit "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë " Nr.7703, date 11.05.1993 (i ndryshuar)

Ligji "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë" me ndryshimet që pësoi me Ligjin nr. 9377 datë 21.04.2005, ndër të tjera solli zgjerim të rrethit të përfituesve. Keto ndryshime kryesisht i vijnë në ndihmë kategorisë së parë të invaliditetit por ende lënë të pambluar kategoritë e tjera.



## Neni 35

### Kushtet e përfitimit

1. Personi që behet i paafte, merr pension invaliditeti, kur ka plotësuar periudhën minimale të sigurimit dhe për çdo arsye, veç aksidentit në punë ose sëmundjes profesionale. Ai e merr këtë pension kur behet i paafte;

a) për çdo veprimtari ekonomike ;

b) kur ka gjymtime të forta dhe dëmtime fizike (duke përfshirë verbimin).

Invaliditeti caktohet nga komisioni mjekësor i caktimit të aftësisë për punë (KMCAP)

Në vendimin e tij shënohen shkaqet e invaliditetit, koha e fillimit të tij si dhe shkalla e humbjes së aftësisë në punë.

Kunder vendimit të KMCAP-it të rrethit personi mund të ankohej në KMCAP-in e prapë pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore, vendim i të cilit përsa i përket caktimit të aftësisë për punë është i formës së prapë.

Rregullat për organizimin dhe funksionimin e KMCAP-ve cakto-

hen me rregulloret e ISSH dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes së Mjedisit.

2. Periudha minimale e sigurimit për pension invaliditeti është sa gjysma e diferencës së moshës së personit të siguruar në kohën që bëhet i paafte dhe moshës 20 vjeç.

Personi, që është në kushtet e invaliditetit të plotë, por që nuk plotëson periudhën minimale të sigurimit, ka të drejtë për pension invaliditeti të reduktuar, në masën që rezulton nga raporti i periudhës së tij të sigurimit me periudhën e duhur për pension të plotë invaliditeti.

3. Personi që përfiton pension për invaliditet, kur plotëson moshën, ka të drejtë të kërkojë pension pleqërie, nëse ky do të jete më i favorshëm për të .

Një element mjaft i rëndësishëm, që pasoi me këto ndryshime, është heqja e detyrimit për të përfituar nga ky ligj edhe kategoritë e personave të cilët ishin bërë të paafte për të punuar gjatë kohës që nuk ishin të siguru-

ar (neni 35 pika 1).

Fillimisht ky kufizim linte jashtë përfitimit nga kjo skemë personat të cilët u ishte kufizuar aftësia për punë, jo gjatë kohës së punës apo për shkak të punës, dhe në këto kushte ata nuk mund të përfitonin nga asnjë ligj tjetër.

Tashmë ky detyrim është hequr por gjithësesi parë në një këndvështrim kritik nga ky nen përfitojnë vetëm kategoritë e parë të invaliditetit dhe përsa i përket kategoritë të tjera gjithçka ka mbetur si më parë, ata mund të përfitojnë vetëm në rast se aftësia e kufizuar ka ndodhur gjatë kohës që personi ka qënë i siguruar.

Gjithashtu për herë të parë neni 35 pika 2 ka parashikuar akordimin e masës së *pensionit të invaliditetit të reduktuar* pavarësisht nga fakti i plotësimit të periudhës minimale të sigurimit.

Konkretisht "Personi, që është në kushtet e invaliditetit të plotë, por që nuk plotëson periudhën minimale të sigurimit, ka të drejtë për pension invaliditeti të reduktuar, në masën që rezulton

nga raporti i periudhës së tij të sigurimit me periudhën e duhur për pension të plotë invaliditeti.” *Neni 35/2*

Si rrjedhim pavarësisht nga fakti se një person nuk ka vitet e duhura të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas përlogaritjes për periudhën minimale të sigurimit, dhe kur aftësia e kukfizar për punë nuk ka ardhur gjatë kohës së sigurimit apo shkaqeve të punës, ligji ka parashikuar edhe për këtë kategori personash përfitimin e një pensioni invaliditeti të reduktur. Edhe ky ndryshim sjell një risi dhe element të rëndësishëm në zgjerimin e rrethit të përfituesve nga skema e sigurimeve shoqërore. Por jo vetëm përsa i përket përfitimit të pensionit të invaliditetit, kjo kategori personash si rrjedhim përfitojnë Statusin e Invalidit të Punës dhe përfitimet e tjera që burojnë nga ky ligj.

Neni 37 i këtij ligji parashikon kushtet për të përfituar pensionin e pjesshëm të invaliditetit. Gjithashtu edhe me anë të këtij neni ka ndryshuar periudha e detyrueshme për përfitimin e këtij pensioni, konkretisht nga 20 vite të detyrueshme për tu plotësuar më parë tashmë kjo shifër është ulur *në jo më pak se 15 vjet dhe jo më shumë se 35 vjet.*

Ky ndryshim i ri ka ndikuar në zgjerimin e rrethit të përfituesve jo vetëm ata me invaliditet por edhe përfitues të pensionit të pleqërisë por nga na tjetër si edhe e kemi përmendur më lart kjo kategori mund të përfitojë vetëm gjatë kohës së sigurimit, duke krijuar kështu elementë “diskriminues” ndërmjet kategorive të invalidëve të punës.

## Bashkëpunimi i Programit Ligjor me Zyrën Përmbartimore Tiranë ndihmoi në zgjidhjen e problemit disavjeçar të Familjes (Koçi) SHEHI

Znj. Flutura (Koçi) Shehi, është invalide e grupit të parë (diagnoza tetraplegji) dhe gëzon Statusin e invalidit tetraplegjik. Ajo është kryefamiljare dhe nëna e Bajramit 12 vjeç, të cilin e rrit me shumë dashuri dhe përkujdesje të veçantë, gjë që nuk ofrohet në të njëjtën mënyrë nga babai i tij (A.K.), me të cilin Znj. Flutura është divorcuar në vitin 2003. Divorci u ligjërua me vendim nga gjykata e shkallës së parë Tiranë, ku ndër të tjera, parashikohej detyrimi i A.K për pagimin e pensionit ushqimor mujor për mirëritjen e fëmijës së tyre, Bajramit.

detyrimit vullnetarisht, si edhe parashikohet në dispozitat e Kodit të Proçedurës Civile. Për disa herë me rradhë Avokatja e programit ligjor në bashkëpunim me Përmbartuesin e çështjes z. Valter Kaçupi në Zyrën Përmbartimore Tiranë, ka kontaktuar në vendin e banimit të debitorit për vënien në dijeni me detyrimet që burojnë nga vendimi i gjykatës, por pasukses.

Si përfundim, u pa e nevojshme përfshirja në këtë bashkëpunim edhe e Komisarariatit të Policisë Vorë për fillimin e ekzekutimit të detyrueshëm, gjë që bëri të mundur fillimin e ekzekutimit të ven-

Pavarësisht nga fakti se vendimi gjyqësor kishte marrë formë të prerë gjithashtu ishte bërë titull ekzekutiv, Zyra Përmbartimore nuk e kishte bërë të mundur zbatimin e tij. Kjo ishte edhe arsyeja për të cilën znj. Flutura i'u drejtua Programit Ligjor pranë FSHDPAK.



Pavarësisht nga fakti se vendimi gjyqësor kishte marrë formë të prerë gjithashtu ishte bërë titull ekzekutiv, Zyra Përmbartimore nuk e kishte bërë të mundur zbatimin e tij. Kjo ishte edhe arsyeja për të cilën znj. Flutura i'u drejtua Programit Ligjor pranë FSHDPAK.

Programi ligjor pasi konsultoi dokumentat e nevojshëm ligjorë dhe qënien e tyre konform ligjit, vendosi kontakte të drejtëpërdrejta me Zyrën Përmbartimore (ku një ndihmë të veçantë ka ofruar edhe vetë znj. Flutura). Bashkarisht me Zyrën Përmbartimore nisën proçedurat paraprake për njoftimin e debitorit me qëllim ekzekutimin e

dimit gjyqësor dhe derdhjen e shumave të prapambetura.

Ky ishte një nga problemet e shumta, të cilat mendojnë znj. Flutura, ku sigurisht një nga më prioritetet është edhe problemi i strehimit pasi ajo është e pastrehe dhe e strehuar përkohësisht në një ambient të përshtatshëm banimi, në pronësi të shtetit. Në këtë mënyrë Programi Ligjor do të vazhdoj ta asistoj ligjëruesit edhe në problematikat e tjera, për zgjidhjen e tyre me sukses.

*Entila Zyba  
Juriste, Koordinatore e  
Programit ligjor te  
FSHDPAK*

Në Shqipëri kemi prindërit tanë dhe gjithë të afërmit prandaj kërkojmë që të kemi një banesë tonën këtu ,pse jo pastaj të sjellim në jetë edhe një fëmijë për ti bërë kështu sfidë kësaj fatkeqësie që na ka goditur vetëm nga një pakujdesi e mjekëve kur kemi qenë të vegjël shprehent çifti I verbër që për fatin e tyre të mirë nuk ju mungon as kurajo e as optimizmi për një jetë më të qetë e më të mirë në të ardhmen.

**A**uk janë si të gjitha çiftet e tjera që tu dregohet dera për tu kthyer andej nga kanë ardhur kur kërkojnë tu zgjidhet problemi I gjetjes së një mundësie strehimi për ta nga bashkia e qytetit.Janë një çift verbërish që përbalimin e problemeve sociale të jetës e kanë më të vështirë se të gjitha çiftet e zakonshme dhe kjo kuptohet qartë por askush në qytetin e Elbasanit deri më sot familjes së Ardian Sericës nuk po I kthen një përgjigje pozitive ose të paktën që ti japë shpresë së një ditë të afërt ata do të jenë të sistemuar në banesën e tyre.

Cifti në fjalë ka krijuar familje prej më se 10 vitesh me shpresë që jeta e tyre për shkak të një fatkeqësie natyrore të mos bëhej edhe më e vështirë por vuajtjet të lehtësoheshin disi pas kësaj. Mirëpo mungesa e një banese për çiftin Serica që për fatin e keq janë burrë e grua të verbër e bën akoma edhe më të vështirë jetën bashkëshortore. Nuk kemi rrestur së kërkuari sistemimin nga ana e bashkisë në një apartament mod-

est sepse nuk kemi kushte në shtëpinë e prindërve ku ndodhemi aktualisht tregon me shumë dhimbje çifti Serica .

Tashmë këtë problem të tyre e njih një qytet I tërë dhe askush nuk e beson që gjetja e një mundësie strehimi për një çift te verber është kaq e vështirë për ta ndërkohë që pushteti vendor ka shpërndarë apartamente gjatë këtyre 10 viteve të fundit për disa kategori të pastrehësh.

Dokumentacionin për të përfutuar strehim e kemi plotësuar me të gjithë formularët e nevojshëm por mesa duket për një çift me aftësi të kufizuara strukturat pushtetit vendor nuk ka mirësinë të tregojnë ndonjëherë një fije humanizmi.Çifti Serica I lodhur sa ska ku të vejë më me sorollatjet e pafund për zgjidhjen e këtij halli vazhdon të këmbëngulë pranë bashkisë së Elbasanit e cila duhet ta sistemojë në një banesë sipas ligjit përkatës për personat me aftësi të kufizuara aq më tepër që fjala është për një familje te verberish të krijuar qysh prej një dekade. “Dikush - thotë çifti Serica, mund

të gjykojë me naivitete se vetë e keni kërkuar belanë që keni vendosur të krijoni familje kur nuk keni mundësi ta përbaloni jetën por askush nuk duhet ta gjykojë kur rë hallin tonë në një këndvështrim të tillë sepse kjo do të ishte fyese”.

Ne jemi njëzëz njëzëz si kushdo tjetër vecse me një ndryshim që kemi pësuar një fatkeqësi në njetë që mos e pastë askush në këtë botë.Edhe gjatë këtij viti çifti Serica nuk ka lënë zyrë të pushtetit vendor pa trokitur për të mundësuar zgjidhjen e problemit të strehimit të tyre në qytetin e Elbasanit por mesa duket nga ajo që u është thënë edhe kësaj rradhe mbetet një përgjigje standarte:

Kur të krijohen mundësitë do të trajtoheni me patjetër gjë që sipas çiftit Serica do të thotë të ngopesh me lugë bosh.Na duket e pabesueshme që të ketë një indiferencë kaq të madhe ndaj një kategorie të tillë çiftesh nga shteti por kur e provon mbi shpinë e kupton se sa e rëndë është kjo.U jemi drejtuar me letra jo rrallë edhe drejtuesve më të lartë të shtetit por nuk kemi marrë ndon-

jë përgjigje pozitive sepse mesa duket sistemimi i një çifti të verbërish për ta nuk është ndonjë çështje për të vënë duart në kokë pasi ka të tjerë që kanë halle e halle më të mëdha. Nga ana e kryebashkiakut të Elbasanit Ardian Turku njihet ky problem i yni shprehet çifti Serica por nuk kemi marrë ende ndonjë premtim konkret prej tij për tu futur në rrugën e zgjidhjes problemi i strehimit për ne. Gjatë këtyre viteve në këtë qytet për strehimin e personave me aftësi të kufizuar është bërë pak ose aspak punë. Kështu që kërkohet që shoqëria e qytetëruar për këtë kategori personash me aftësi të kufizuar të jetë më e ndjeshme në këtë aspekt. Çifti Serica përkohësisht jeton në qytetin Nansy të Francës ku janë të sistemuar në një apartament me të gjitha kushtet qeranë e të cilit e paguan shërbimi social i këtij shteti. Por ne nuk kemi ndërmend të jetojmë atje megjithëse nuk na mungon gjë thonë bashkëshortët Serica nga qyteti i Elbasanit. Ne shpresojmë se shumë shpejt do të rikthehemi në qytetin tonë.

Në Shqipëri kemi prindërit tanë dhe gjithë të afërmit prandaj kërkojmë që të kemi një banesë tonën këtu, pse jo pastaj të sjellim në jetë edhe një fëmijë për ti bërë kështu sfidë kësaj fatkeqësie që na ka goditur vetëm nga një pakujdesi e mjekëve kur kemi qenë të vegjël shprehent çifti i verbër që për fatin e tyre të mirë nuk ju mungon as kurajo e as optimizmi për një jetë më të qetë e më të mirë në të ardhmen.

*Luiza Popja  
Juriste e programit  
ligjor të FSHDPAK  
ne Elbasan*



## Për një transport të përshtatur për personat me aftësi të kufizuar

**Gjithpërfshirja e PAK në jetën shoqërore është një nga objektivat kryesorë të Strategjisë Kombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuar, në të cilën janë parashikuar objektiva dhe masa konkrete për realizimin, ndër të tjera, edhe të një transporti të përshtatur që mundëson lëvizjen e pavarur dhe është parakusht për integrimin e personave me aftësi të kufizuar në jetën shoqërore.**

**N**ë kuadrin e përpjekjeve ndërgjegjëse për të mundësuar integrimin dhe gjithëpërfshirjen e Personave me Aftësi të Kufizuar në jetën shoqërore, duke synuar nxitjen dhe përshtetimin e procesit të realizimit të një transporti dhe telekomunikacioni të përshtatur për PAK, Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar, organizoi

tryezën e rrumbullakët me temë "Transport dhe Telekomunikacion i Përshtatur për Personat me Aftësi të Kufizuar", me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Institucione Qëndrore dhe Vendore, OJF të Aftësisë të Kufizuar.

Gjithpërfshirja e PAK në jetën shoqërore është një nga objektivat kryesorë të Strategjisë Kombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuar, në të cilën janë parashikuar objektiva dhe masa

konkrete për realizimin, ndër të tjera, edhe të një transporti të përshtatur që mundëson lëvizjen e pavarur dhe është parakusht për integrimin e personave me aftësi të kufizuar në jetën shoqërore.

Pjesëmarrësit e kësaj tryeze, pasi u njohën me materjalin e përgatitur nga juristja e FSHDPAK, në lidhje me legjislacionin bashkëkohor dhe zhvillimet në lëvizjen europiane për një transport të përshtatur, diskutuan mbi gjendjen aktuale të transportit në Shqipëri, si duhet të përmirësohet për ta bërë atë të përdorshëm nga të gjithë.

U evidentua që e vetmja arritje është ofrimi i shërbimit pa pagesë në transport për vetëm disa grupime të aftësisë së kufizuar, duke lënë të përjashtuar të gjithë ata që nuk përfitojnë nga statuset, në mënyrë të vecantë dhe më të diskriminuar personat me aftësi të kufizuar mendore, të cilët nuk kanë ende mbështetjen e duhur ligjore si edhe janë në fokus të qëndrimeve negative, fyese e poshteruese gjatë përdorimit të mjeteve të transportit.

Ndërkohë nuk ofrohet asgjë tjetër në legjislacion dhe praktika që të mundësojnë transport për të gjithë. Për këtë arsye, u theksua në tryezë, është e domosdoshme të bëhen ndryshime, bazuar në rekomandimet e mëposhtme:

- Përfshirja në ligjin e përgjithshëm të transportit e problematikës së përshtatshmërisë për PAK. Përshtatja e Ligjit me Direktivat e Komunitetit Europian.

- Hartimi i Normave Vendore të përshtatshmërisë ndërtimore, të infrastruktures e transportit ( në rang bashkie e komune )

- Përfshirja në sanksionet e licensimit të mjeteve lëvizëse edhe detyrimi për përshtatshmëri për PAK.

simit.

- Ndërhyrje e menjëherëshme në transportin hekurudhor për hartimin e akteve nenligjore të posacme.

- Forcimi i rolit bashkëpunues MPPTT me Bashkinë e Tiranës për mjete dhe sinjalistikë të përshtatur.

- Përmirësim ligjor në lidhje me mënyrën dhe mjetin e identifikimit të PAK përfitues.

- Krijimi i përshtatsh-



- Bashkëpunim i institucioneve përgjegjëse me Drejtorinë e Standarteve për të realizuar sigurinë e procesit.

- Ngarkimi me përgjegjësi i Min. së Financave për të zbatuar legjislacionin egzistues të rimbur-

mërisë së shërbimit, krahas asaj fizike, në transportin rrugor, hekurudhor, ajror e detar për PAK.

*Bardhylka Kospiri  
Koordinatorë e Programit të avokatise se  
FSHDPAK*

# Got nis një jetë e re



***“Une do te jem i dobishem per familjen time sepse tani mund te dal te punoj dhe t`ju siguroj nje jetese me te mire, do te shikoj dhe Tiranen sa ka ndryshuar, do te bej shume gjera qe vetem i enderroja nga pamundesia e ecjes me kembet e mia, jam i lire.***

***Mendoka dikush dhe per ne romet me aftesi te kufizuara, pasi dhe ne jemi si gjithë te tjeret dhe kemi te drejte ta shijojme jeten” .***

**N**dihmojeni ate djale se eshte shume i varfer dhe eshte njeri i mire me tha nje grua qe takova sapo u futa ne nje lagje Rome tek Bregu i Lumit dhe kerkova Ardianin.

Ardian Sula eshte 35 vjec dhe prej 4 vjetesh vuan nga gangrena.

Para 4 vjetesh nderkohe qe ndodhej ne Greqi teksa kalonte shinat e trenit e perplas treni dhe ky aksident i demtoi rende kembet. Eshte babai i 3 femijeve nderkohe qe dhe 2 te tjere i kane vdekur nga kushtet shume te keqija te jeteses pasi banesa e Ardianit eshte nje kasolle ne Bregun e Lumit ku as per te

mbrojtur nga shiu familjen e tij nuk sherben e jo me te plotesoje kushtet minimale te jeteses.

Pas aksidentit çdo gje ndryshoi ne jeten e tij pasi pamundesia per te punuar çoi ne perkeqesimin e gjendjes financiare sepse dhe shpenzimet per sherbimet shendetesore ishin shume te medha.

Duke mos pasur asnje mundesi per te qendruar ne Greqi detyrohet te kthehet ne Shqiperi duke e nisur çdo gje nga fillimi por me nje ndryshim tani ishte me aftesi te kufizuar. Ardiani e kalonte gjithë ditën mbyllur ne shtëpi nderkohe qe gruaja dhe femijet e tij te vegjel mblidhnin

kanaçe per ti shitur qe me pas te mund te ushqeheshin, dhe kjo ishte shume e rende per Ardianin pasi nuk mund ti sherbeje si çdo kryefamiljar familjes se tij.

Por ne fakt ai nuk kerkonte as ndihma financiare dhe as ushqimore ai kishte shume nevojë per nje karrike me rrota dhe per te cilën kishte bere nje kerkese prane FSHDPAK dhe ju duk e pabesueshme kur ne shtepine e tij erdhi nje punonjese e ketij Fondacioni dhe solli nje karrike me rrota per te pasi shpresat i kishte te pakta, sepse kudo qe kishte trokitur per hallet e tij ishin te pakta ato dyer qe ishin



hapur sipas tij per faktin se Ardiani eshte rom dhe paragjykimet jane te shumta per kete kategori te shoqerise. Lexohej qarte gezimi ne syte e tij kur pa karriken me rrota pasi per te do te thote pavaresi, por ishte dhe pak i hutuar njekohesisht sepse ishte hera e pare qe ulej ne nje te tille.

Pasi u ul ne ate karrike me rrota duke qeshur tha: "Atehere dhe une do te jem i dobishem per familjen time sepse tani mund te dal te punoj dhe t'ju siguroj nje jetese me te mire,do shikoj dhe Tiranen sa ka ndryshuar do bej shume gjera qe me ishin privuar nga pamundesia e ecjes me

“ Kjo karrike me rrota jo vetem qe do te me ndihmoje mua qe te jem i pavarur por dhe gruaja ime do jete shume me e lehtesuar se pervec lodhjes qe kishte gjate dites duke punuar dhe kujdesit per femijet i duhej dhe te me sherbente mua pasi nuk kisha mundesi te levizja. ”

kembet e mia,jam i lire". Atehere dhe per ne romet me aftesi te kufizuara mendoka dikush pasi dhe ne jemi si gjithe te tjeret dhe kemi te drejte ta shijojme jeten tha ai.

Kjo karrike me rrota jo vetem qe do te me ndihmoje mua qe te jem i pavarur por dhe gruaja ime do jete shume me e lehtesuar se pervec lodhjes qe kishte gjate dites duke punuar dhe kujdesit per femijet i duhej

dhe te me sherbente mua pasi nuk kisha mundesi te levizja.

Sot qe mora kete karrike me rrota nis nje jete e re per mua dhe dua ta shijoj aq sa te kem mundesi sepse mendoj meqe zoti me dha dhe nje mundesi per te jetuar pasi u aksidentova perse mos ta shfrytetoj ne maksimum.

Zamira Mulaj  
Koordinatorë e  
shperndarjes, FSHDPAK

## Nje enderr qe nuk kisha patur guximin ta enderroja

**D**ita e parë e shkollës për Geldin, djalin tim të madh, ishte me 23 gusht 1995, dy ditë para se ai të mbushte 10 vjeç. Ai hyri me frikë në ndërtesën e madhe një katëshe të shkollës fillore duke më shtërnguar fort dorën e djathtë. Unë i buzëqesha si për t'i thënë që gjithçka do të shkonte mirë, ndërkohë që zemra më rrihte me emocion. Në një farë mënyre po përjetoja një nga ato çastet, ku realiteti ishte me afër irreal se reales. Geldi kish pësuar dëmtim në tru gjatë një lindje të vështirë dhe ai ish diagnostikuar me prapambetje mendore të thellë, epilepsi dhe paralizë cerebrale. Në Tiranë, ku ai kish lindur, kish një shkollë speciale, por ajo ishte për femijët me prapambetje mendore të lehtë, dhe nuk pranonte femijë që kishin vështirësi funksionale që kish Geldi. Sa për shkollat e zakonshme, aty as nuk me kish vajtur mendja të pyesja. Në ato kohe me kishin thënë që jo të gjithë femijet mund të edukoheshin dhe unë e kisha pranuar atë si një të vertetë të dhimbshme, pa arsyetuar gjatë. Kështu kishin kaluar vitet, deri në këtë ditë gushti, ku në një vend të largët pranë maleve Roki në Kolorado të Shteteve të Bashkuara të Amerikës unë po përshkoja korridorin e zhurshëm të një shkolle të zakonshme sebashku me Geldin. Nderkohe kishim arritur tek klasa e mesuese Anitës, nga dera e hapur e të ciles vinte një muzikë gazmore. Geldi me foli me sy e sikur me tha: “Ç’do të bëj këtu?” Unë i dhashe një të shtyre me dorë në sup dhe i thashe: “Hy, zemra e mamit. Do të jesh mirë.” Kështu filloi përvoja jonë me arsimin e integruar që vazhdoi për nëntë vjet me radhe, deri në maj të vitit 2004, kur Geldi mbaroi shkollën e mesme dhe mori çertifikatën e

perfundimit të studimeve se bashku me të gjithë nxenesit e Klases 2004 të shkolles Rocky Mountain High në ceremoninë e organizuar në pallatin e sportit. Geldi zhvillonte mesimet me plan edukativ individual që hartohej në fillim të çdo viti shkollor. Plani bazohej në mundësitë dhe nevojat mesimore të Geldit dhe zbatimi i tij bëhej në dy forma: individualisht dhe në grup. Një pjesë të ditës, Geldi kalonte me mesuesen e tij të kualifikuar për arsim special si edhe me specialiste të tjera (terapistë okupacionalë, terapiste të folurisë, terapiste fizike fizike apo terapiste muzike). Ndersa pjesën tjetër Geldi kalonte në klasën e zakonshme, me bashkëmoshataret, i ndihmuar nga një ndihmes-mesuese. Mesimet në klasën e zakonshme përshatëshin në përputhje me mundësitë e Geldit nga mesuesit e lendeve perkatese. Në klasë Geldi ndihmohej jo vetëm nga ndihmes-mesuesja e tij, por edhe nga nxenesit e tjerë të klases, me shumë nga të cilët ai krijoi miqësi të ngushta që vazhdojnë edhe sot.

Te gjithë mesuesit që Geldi pati në shkollë fillore (elementary school), në shkollën e mesme të ciklit të ulët (Junior high) dhe në shkollën e mesme të ciklit të lartë (high school) kishin marrë njohuri dhe shprehje praktike të arsimit special gjithëpërfshirës në programin e universitetit dhe kualifikimit profesional. Ata jo vetëm që e mirepritën Geldin në të gjitha orët e mesimit si një nxenes i rregullt, por i dhane atij mundësinë të shtonte njohuritë dhe të zhvillonte më tej shprehjet praktike perkatese në përputhje me mundësitë e tij, duke u nisur nga parimi se “kerkesat e larta inkurajojnë të nxenit”. Gjatë detyrave mesimore në klasë, Geldi i jepej mundësia të kontribonte në mënyrën e tij dhe cilesia e punës së tij vlerësohej sipas treguesve të percaktuar në planin e tij individual të edukimit. Kur kthehej

nga shkolla, Geldi me tregonte me krenari dosjen e punimeve te tij dhe shenimet e mesueve.

Ne klase Geldi shkonte me nje ndihmes-mesuese, qe e ndihmonte ne kryerjen e detyrave si edhe i jepte mbeshtetjen e duhur per t'u integruar. Nina qe nje nga ndihmes-mesueset qe luajti nje rol shume te madh ne zhvillimin e pavaresise se Geldit. Jo me shume se njezet vjec, Nina kish qene nxenese ne shkollen Rocky Mountain High, dhe ajo ndjehesh aty si ne shtepi te vet. Ajo jo vetem qe e ndiqte Geldin ne mesim, por edhe e inkurajonte te merrte pjese ne te gjitha aktivitetet jashteshkollore duke bere çmos qe ai te rrethohej nga miq te shumte e dashamires.

Nga te gjitha miqte e tij te shkolles, Lindsay (Linzi) ze vendin e pare ne zemren e Geldit. E gjate, shtatholle, me floke te zija te gjate e me sy gjithe drite ajo e fitoi dashurine e Geldit qe kur filloi te shoqerohej me te si "peer helper" (ndihmese-shoqe) ne shkolle te mesme. Si shkolla e mesme e ciklit te ulet, ashtu edhe shkolla e mesme e ciklit te larte u jepte mundesine nxenesve te merrnin kredite mesimore (te barazvlefshem me lende mesimore praktike) per punen qe benin me nxenesit me nevoja te veçanta. Keta ndihmes-shoke dhe ndihmes-shoqe shoqeroheshin ne shkolle dhe ne aktivitetet jashteshkollore me nxenesit me aftesi te kufizuara. Ne shkollen e Geldit kishtin ngritur nje klub nxenesish qe e quanin the Connection Club (Klubi i Lidhje). Klubi drejtohej nga nje terapiste zbavitjeje (recreation therapist) dhe misioni i tij ishte i dyfishte: te siguronte gjithepershirjen e nxenesve me aftesi te kufizuara ne veprimtarite jashteshkollore te organizuara nga shkolla si ndeshje sportive, shfaqje artistike, mbremje, etj., si edhe krijonte mundesine per pjesemarrjen e nxenesve me aftesi te kufizuara ne veprimtarite e ndryshme shlodhese, artisike dhe sportive ne komunitet sebashku me moshataret e tyre. Geldi ka shkuar me miqte e tij te Connection Club ne çdo mbremje te

shkolles, ne kinema, ka luajtur minigolf, ka luajtur bouling, ka dale neper dyqane, ka shkuar ne pishine etj.

Por ajo qe mund te quhet nje nga ngjarjet me te paharruara te shkolles qe pjesëmarrja ne mbremjen e matures, ne "prom" siç e quajne maturantet. Lindsay ishte vajza qe shkoi me Geldin ne mbremjen e matures, e veshur me nje fustan bojeqielli qe kombinonte me kemishen bojeqielli e kostumin blu te Geldit e me nje lule zambaku ne dore (korsazh). Ata hypen sebashku ne limuzinen a bardhe per te shkuar ne restorant dhe mua m'u duk se Geldi nuk eci, po fluturoi perkrah saj.

Klasa 2004 e beri ceremonine e diplomimit ne pallatin e sportit te universitetit qe zinte rreth 2000 vete. Ate te diele maji, ajo ishte mbushur plot me prinder e te aferm te diplomanteve. Keta te fundit kishin zene te gjitha fushen, te ulur ne karrike.

Mes tyre, aty ne rreshtin e dhjete, i veshur me rroben tradicionale te festes se diplomimi me mendafsh te kuq ishte dhe Geldi. Prane tij qendronte Nina, qe here pas here i rregullonte kapelen qe nuk i kish zene vend mire. Pas fjales se rastit, filloi shperndarja e diplomave. Nje mesues i shkolles thosh emrin e nxenesit, te afermit dhe shoket e tij duartrokitnin dhe pastaj ai ngjitej ne podium dhe e merrte diplomen nga drejtori i shkolles. Kur mesuesi tha emrin e Geldit, me shume se peseqind vete u ngriten ne kembet duke duartrokitur dhe ata u apsuar nga te gjitha te pranishmit. Disa thirren: "Te lumte, Geldon!" Ndersa Geldi ecte duke buzeqeshur, paksa i hutuar, ne drejtim te drejtorit te shkolles, une isha mbushur e gjitha ne lote. E kisha te veshtire te mbaja ngasherimin, teksa zemra me hovte me gezim. Geldi kish mbaruar shkollen e mesme dhe une kisha realizuar nje enderr qe dikur nuk kisha patur guximin as ta enderroja!

*Marita Nika Flagler*

*Mamaja e Geldit*

*Marre nga: "Libri i historive te jetes se personave me aftesi te kufizuar".*

# SI TË GATUAJMË

## TAVË PLËNDËSI ME QEPË

### Për 5 persona

|   |                |
|---|----------------|
| Plëndës viçi                            | 1.5 kg         |
| Qepë të thata                           | 1 kg           |
| Miell                                   | 1 lugë gjelle  |
| Salcë domate                            | 1 lugë gjelle  |
| Hudhra                                  | 5 thelpinj     |
| Uthull                                  | 1 filxhan çaji |
| Vaj                                     | 200 gr         |
| Kripë, piper, rigon,<br>1 gjethe dafine |                |



### PREGATITJA

Plëndësin e larë e ziejmë në zjarr të avashëm dhe e presim në disa porcione. Në një tenxhere skuqim mirë qepën e grirë hollë, shtojmë kripën, miellin dhe e përziejmë. Duke vazhduar skuqjen, shtojmë hudhrat, dafinën dhe salcën e daomates. Masën e përftuar e shtrojmë në tavë bashkë me plëndësin dhe e pjekim në furrë për 40-45 minuta. Kur të jetë formuar një cipë sipër tavës, nxirret nga furra dhe lihet të ftohet pak. Shërbehet e ngrotë dhe shoqërohet me verë të bardhë.

## DOBIA E VAJIT TË ULLIRIT?


Ndërmjet të tjerave vaji i ullirit....

- Ushqen lëkurën , e ruan dhe zbut atë , i jep asaj freski . Ai është vaji që asimilohet më me lehtësi nga trupi i njeriut .
- Në rast se vaji i ullirit pihet para ngrënies , ai mbron stomakun nga sëmundjet e ulçrëas .
- Kur pihet me limon ose kafe , mënjanon kapsllëkun .
- Vaji i ullirit , gjithashtu ndikon pozitivisht në rrugët urinare , ul sasinë e kolesterolit në gjak
- Pakëson rrezikun e sëmundjeve të zemrës .
- Kur mbahet në gojë zbardhëllon dhëmbët. Përdoret gjithashtu për masazh dhe fërkimet e trupit.

## KABUNI ME RRUSHË TË THATË

### Për 5 persona

|                         |            |
|-------------------------|------------|
| Oriz                    | 400 gr     |
| Sheqer                  | 400 gr     |
| Gjalp                   | 100 gr     |
| Rrush i thatë           | 100 gr     |
| Lëng mishi<br>(ose ujë) | 4 gota uji |
| Pak kanellë             |            |



### Pregatitja

Skuqim duke e përziher në një tenxhere 2 lugë gjelle sheqer derisa të marrë ngjyrë bezhë. Shtojmë mbi të lëngun e mishit (pule ose qengji), ose ujë, rrushin e thatë dhe kanellën. I japim një valë dhe shtojmë orizin. Pasi e përziejmë, e mbulojmë me kapak dhe e lëmë derisa të ziejë orizi. Shtojmë masën e sheqerit dhe e përziejmë sat ë përthithet sherbeti i krijuar. Ndahet në forma dhe i hidhet sipër përzjerja e sheqerit me kanellë.

Josif Mio, Shef Kuzhine  
Person me aftësi të kufizuar në të shikuar, Berat